



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Doretuar Prilimja / Prodato Received / Delivery	31.10.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHCK	6787/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1164/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1164/2023 të datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi rr. "Marin Barelti" Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1164/2023 e datës 15.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

Nëpunësi civil [redacted] i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2" në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112/01-37855 të datës 16.12.2021, me datë 15.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6097/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor lidhur me anulimin e konkursit të datës 15.02.2023 Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në Komunën e Gjakovës si dhe ndaj vendimit nr.01-112/0215977 të datës 14.08.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa Këshilli më datë 17.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6097/2023 të datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër nr.01-112/0215977 i datës 14.08.2023 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; E-mail i datës 29.03.2023; E-mail i datës 04.04.2023; Dokumenti i verifikimit paraprak pozita Udhëheqës i Sektorit të Sportit i datës 04.04.2023; E-mail nga L.R. për D.N. i datës 07.04.2023; Njoftim i datës 04.04.2023; Pliko me numër R5404093 i datës 13.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 17.10.2023; Akt Emërim i D.N. me numër AE.Nr.01-112/01-37855 i datës 16.12.2021; Konkurs Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Sportit në Komunën e Gjakovës i datës 15.02.2023; Vendim për Formimin e Komisionit të vlerësimit me numër Nr.01-112/02-4217 i datës 24.02.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; E-mail nga T.K. për K.B. i datës 04.04.2023; Njoftim nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës i datës 04.04.2023; Aplikacioni i D.H. i datës 29.03.2023; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës për D.N. me numër Ref. Nr. R-162/04-04/77 i datës 21.10.2010; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për D.N. me numër Nr.02-699 i datës 18.07.2013; Certifikatë nga CDE për D.N. i datës 17.01.2014; Certifikatë nga MPMS për D.N. me numër Nr.76/2012 i datës 06.04.2012; Certifikatë nga MPMS për D.N. me numër Nr.55/2012 i datës 16.03.2012; Certifikatë nga agjensioni për shërbime sociale edukative për D.N.; Certifikatë ipsia për D.N. i datës 18.11.2011; Certifikatë nga Egnatia academy për D.N. i datës 27.05.2010; Aplikacioni i D.N. i datës 29.03.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës i D.N. me numër Nr.2982 i datës 24.01.2023; Certifikatë nga Kolegji Iliria për D.N. i datës 10.03.2016; Vërtetim nga zyra e personelit Komuna e Gjakovës i datës 24.12.2014; Certifikatë nga EU-kosvet VI për D.N. i datës 17.09.2014; Certifikatë nga MPMS për D.N. i datës 09.03.2016; Vërtetim nga Banka Ekonomike SH.A. për D.N. me numër Nr.2071 i datës 21.05.2007; Vërtetim nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për D.N. i datës 09.04.2007; Certifikatë nga Oda Ekonomike e Kosovës për D.N. me numër 093 i datës 10.09.2007; Akt Emërim i D.N. me numër AE.Nr.01-112/01-37855 i datës 16.12.2021; Vendim me numër Nr.01-112/02-34111 i datës 09.11.2021; Akt Emërim i D.N. me numër 01-112/01-15403 i datës 20.06.2017; Vërtetim për masa disiplinore për D.N. me numër 112/122/2023 i datës 03.03.2023; Aplikacioni i L.E. i datës 23.03.2023; Diplomë e shkollës së mesme nga Sh.M. Ekonomike "K. Kusari" e L.E. me numër protokolli 100 i datës 10.06.1998; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për L.E. me numër Nr.418 i datës 03.07.2012; Certifikatë nga FFK për L.E. i datës 16.11.2018; Vërtetim nga Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë për L.E. me numër nr.406 i datës 04.10.2021; Diplomë nga Cyber school për L.E. i datës 20.11.2001; Certifikatë nga KRPP për L.E. me numër nr.082 e muajit Tetor 2022; Letërnjoftim i L.E.; Akt Emërim i L.E. me numër AE.Nr.01-112/01-38032 i datës 20.12.2021; Vërtetim për masa disiplinore për L.E. me numër 112/148/2023 i datës 23.03.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve

civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesionale i L.E. i datës 27.01.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit të ankuesit me numër AE.Nr.01-112/01-37855 të datës 16.12.2021, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2" në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komuna e Gjakovës me datë 15.02.2023 ka bërë njoftimin për shpalljen e Konkursit Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në Komunën e Gjakovës ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.03.2023-29.03.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar tre (3) kandidatë gjithsejtë, ndër ta edhe ankuesi [REDACTED]. Ndërsa me datë 04.04.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës është bërë publikimi për kandidatët lidhur me verifikimin paraprak ku gjithsejtë janë tre (3). Po ashtu të njëjtën ditë me datë 04.04.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës është bërë Njoftimi me arsyetimin se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore njofton të gjithë kandidatët se anulohet e procedura e ngritjes (avancimit) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit", me numër RN00011021 të publikuar me datë 15.02.2023. Ankuesi lidhur me anulimin e konkursit është njoftuar përmes e-mailit nga Zyrtarja e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës përmes e-mailit me datë 07.04.2023 lidhur me Njoftimin për anulimin e procedurës Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në Komunën e Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka konstatuar se ankuesi është njoftuar përmes e-mailit nga Zyrtarja e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës përmes e-mailit me datë 07.04.2023 lidhur me Njoftimin për anulimin e procedurës Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në Komunën e Gjakovës, ndërsa ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.09.2023, Kolegji i Këshillit si rrjedhojë e kësaj nuk është lëshuar në arsyet e anulimit të konkursit të lartcekur pasi ankesa e tij është e pas afatshme.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", si rrjedhojë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me pretendimin ankimor lidhur me anulimin e konkursit të datës 15.02.2023 Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në Komunën e Gjakovës.



Duke marrë parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*, si rrjedhojë meqenëse ankuesi me datë 07.04.2023 ka pranuar e-mailin nga Zyrtarja e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës lidhur me Njoftimin për anulimin e procedurës Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *"Udhëheqës i Sektorit të Sportit"* në Komunën e Gjakovës, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 15.09.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit kundër vendimit me numër nr.01-112/0215977 të datës 14.08.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, lidhur me caktimin e nëpunësit F.C. i sistemuar në punë *"Udhëheqës i Sektorit për Kulturë"*, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, transferohet përkohësisht që të ushtrojë edhe detyrat e *"Udhëheqës i Sektorit të Sportit"* në të njëjtën Drejtori.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik (që ka qenë në fuqi), konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj/tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...Kolegji i Këshillit vlerëson se me vendimin e kundërshtuar në ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa e ankuesit është e papranueshme.*

Andaj, nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1164/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.